



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1324/ 5 prot.

Datë 05.07.2022

V E N D I M
Nr. 633/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-32771-06-14-2022 me objekt “Blerje bojëra për printer e fotokopje”, me fond limit 5,800,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27-06-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit me objekt “**Blerje bojëra për printer e fotokopje**”, me fond limit 5,800,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27-06-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz
Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Ankimues:

“Infosoft Office” SHPK
Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulet monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 15-06-2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-32771-06-14-2022 me objekt “Blerje bojëra për printer e fotokopje”, me fond limit 5,800,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27-06-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 21.06.2022 , operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur ankesë në mënyrë elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, me anë të Sistemit të Ankesave Elektronike, me numër ankimi elektronik A/2022/2294 duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1324/2 prot., datë 28.06.2022 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në procesverbalin përkatës, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK

II.5 Nëpërmjet shkresës nr.5831 prot., datë 27.06.2022 protokolluar me tonën me nr.1324/3 prot., datë 29.06.2022 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoriteti kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Bashkëlidhur shkresës së mësipërme, ku nga verifikimi konstatohet, se është paraqitur akti i trajtimit të ankesës me nr. Prot 5831 , datë 27.06.2022 nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht një nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si më poshtë vijon:

“[...] 2Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentet e tenderit dhe ankesën e operatorit ekonomik dhe konstatoi se:

-Lidhur me pretendimin: [...] me kërkesën mbi "vulat e sigurisë, shiritin e sigurisë dhe skadencën", bëjmë me dije se janë kërkesa që varen nga politikat e prodhuesit dhe nuk është në kompetencën e OE, të përcaktojë detaje të tilla. Shumë tonera në përgjithësi dhe konkretisht të gjithë artikujt objekt i këtij prokurimi, nuk skadojnë dhe nuk është në mundësinë e OE, të

detyrojnë prodhuesit të shprehen mbi datën e skadencës, apo të vendosin vula apo shirita sigurie, nëse këto nuk janë në strukturën e produktit. Në këto kushte, kërkojmë që për kërkesat e mësipërme, të shtohet shprehja: "kur është e aplikueshme nga prodhuesi".

-Në sistemin e prokurimit elektronik do të hartohet një SHTOJCË duke e modifikuar kriterin si më poshtë:

Produkt origjinal i Printerit, paketim origjinal nga prodhuesi, me vula sigurie (kur janë të aplikueshme nga prodhuesi), shirit sigurie, brenda datës së skadencës (kur bojërat janë likuide (të lëngshme) duhet të jenë brenda afateve të skadencës).

Ju sqarojmë se, Autoriteti kontraktor kërkon që tonerat të jenë origjinale. Shiritat e sigurisë i kanë të gjithë tonerat origjinale, për këtë arsye kërkon që tonerat të kenë shiritat e sigurisë. Për sa i përket afateve të skadencës kjo është për bojërat likuide, pra kur bojërat janë likuide (të lëngshme) duhet të jenë brenda afateve të skadencës.

-Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për shtojcën 5 (Formulari i Specifikimeve Teknike) që AK ka kërkuar: "Tonerat të jenë të paketuara në qese dhe kuti kartoni të pahapura nga prodhuesi shoqëruar me pullën përkatëse të sigurisë (HALOGRAMA)".

Në sistemin e prokurimit elektronik do të hartohet një SHTOJCË duke e modifikuar kriterin si më poshtë:."

Tonerat të jenë të paketuara në qese dhe kuti kartoni të pahapura nga prodhuesi shoqëruar me pullën përkatëse të sigurisë (HALOGRAMA) kur është e aplikueshme nga prodhuesi.

-Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për shtojcën 6 Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit të kolona Modeli për artikujt nr. 12 dhe nr.14 është bërë një gabim në kodet e tyre.

Në sistemin e prokurimit elektronik do të hartohet një SHTOJCË duke i modifikuar kërkesat si më poshtë:

12 Kyocera Ecosys FS-1300D ---- Kyocera DK-130 Drum Unit grup ----- Copë 9

14 Kyocera Ecosys FS-1370dn----- Kyocera DK-170 Black Drum Unit -----Copë 5

-Përsa i përket pretendimit për ekuivalencën e kodeve të tonerave sqarojmë se: Në pikën 2.3.6 të DT është kërkuar deklarata që përmban:

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Tonerat që kërkohen duhet të jenë tonera origjinale OEM ose ekuivalent, të jenë të reja dhe të pahapura, jo të rimbushura, jo të ricikluara.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara (numrit të printimeve).

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet pasi ky pretendim qëndron i vendosur në dokumentet e tenderit të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik.

II.6 Nëpërmjet shkresës nr.5956/1 prot,datë 30.06.2022 protokolluar me tonën me nr.1324/4 prot., datë 05.06.2022 me lëndë "Shkresë përcjellëse", është depozituar pranë Komisionit të

Prokurimit Publik informacioni i autoriteti kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesës të autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke pranuar disa prej pretendimeve si më poshtë vijon:

"[...] 2Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentet e tenderit dhe ankesën e operatorit ekonomik dhe konstatoi se:

-Lidhur me pretendimin: [...] me kërkesën mbi "vulat e sigurisë, shiritin e sigurisë dhe skadencën", bëjmë me dije se janë kërkesa që varen nga politikat e prodhuesit dhe nuk është në kompetencën e OE, të përcaktojë detaje të tilla. Shumë tonera në përgjithësi dhe konkretisht të gjithë artikujt objekt i këtij prokurimi, nuk skadojnë dhe nuk është në mundësinë e OE, të detyrojnë prodhuesit të shprehen mbi datën e skadencës, apo të vendosin vula apo shirita sigurie, nëse këto nuk janë në strukturën e produktit. Në këto kushte, kërkojmë që për kërkesat e mësipërme, të shtohet shprehja: "kur është e aplikueshme nga prodhuesi".

-Në sistemin e prokurimit elektronik do të hartohet një SHTOJCË duke e modifikuar kriterin si më poshtë:

Produkt origjinal i Printerit, paketim origjinal nga prodhuesi, me vula sigurie (kur janë të aplikueshme nga prodhuesi), shirit sigurie, brenda datës së skadencës (kur bojërat janë likuide (të lëngshme) duhet të jenë brenda afateve të skadencës).

Ju sqarojmë se, Autoriteti kontraktor kërkon që tonerat të jenë origjinale. Shiritat e sigurisë i kanë të gjithë tonerat origjinale, për këtë arsye kërkon që tonerat të kenë shiritat e sigurisë. Për sa i përket afateve të skadencës kjo është për bojërat likuide, pra kur bojërat janë likuide (të lëngshme) duhet të jenë brenda afateve të skadencës.

-Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për shtojcën 5 (Formulari i Specifikimeve Teknike) që AK ka kërkuar: "Tonerat të jenë të paketuara në qese dhe kuti kartoni të pahapura nga prodhuesi shoqëruar me pullën përkatëse të sigurisë (HALOGRAMA)".

Në sistemin e prokurimit elektronik do të hartohet një SHTOJCË duke e modifikuar kriterin si më poshtë:."

Tonerat të jenë të paketuara në qese dhe kuti kartoni të pahapura nga prodhuesi shoqëruar me pullën përkatëse të sigurisë (HALOGRAMA) kur është e aplikueshme nga prodhuesi.

-Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për shtojcën 6 Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit të kolona Modeli për artikujt nr. 12 dhe nr.14 është bërë një gabim në kodet e tyre.

Në sistemin e prokurimit elektronik do të hartohet një SHTOJCË duke i modifikuar kërkesat si më poshtë:

12 Kyocera Ecosys FS-1300D ---- Kyocera DK-130 Drum Unit grup ----- Copë 9

14 Kyocera Ecosys FS-1370dn----- Kyocera DK-170 Black Drum Unit -----Copë 5

-Përsa i përket pretendimit për ekuivalencën e kodeve të tonerave sqarojmë se: Në pikën 2.3.6 të DT është kërkuar deklarata që përmban:

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Tonerat që kërkohen duhet të jenë tonera origjinale OEM ose ekuivalent, të jenë të reja dhe të pahapura, jo të rimbushura, jo të ricikluara.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara (numrit të printimeve).

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet pasi ky pretendim qëndron i vendosur në dokumentet e tenderit të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik.

II.1.2.. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3 Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë

të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK se:[...] Ne

kriterin 2.3.9 OE duhet të paraqesi mostrat e artikujve sipas numrave rendor. Vihet re se janë kërkuar mostra për një numër të madh artikujsh, duke krijuar kështu kosto të larta për OE ofertues. Një pjesë e mirë e modeleve të printerave, janë shumë të vecanta dhe në të gjithë eksperiencën tonë, janë kërkuar vetëm nga institucioni juaj. Në këto kushte, këto mostra do të ishin kosto të pajustificueshme për OE, pasi vetëm fituesi do të mund të perdorte ato. Psh produktet e markes Canon, konkretisht psh art. 4, që nuk është as toner, por thjesht tela për (staples) për pajisjen, etj. Nr Emertimi i Printerit Modeli njesia sasia 4 Canon IR-Advance 6565 Finisher V1 Staples per Cartridge - Type X1 box of 3 set 50[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat e artikujve për numrat rendor 1, 4, 5, 6,10, 12,15, 16,18,22,27, 29,30,31. (sipas tonerave të përcaktuar në tabelën e përgjithshme në shtojcën nr. 6. Sasia dhe grafiku i lëvrimin),

Nr.	Emertimi i Printerit	Modeli	njesia	sasia
1	Canon IR-Advance 6565	Toner C-EXV36	Cope	38
2	Canon IR-Advance 6055	Drum Canon IR-Advance 6055	cope	5
3	Canon IR-Advance 6055	Canon imageRUNNER ADVANCE 6055 Fuser (Komplet)	Cope	4
4	Canon IR-Advance 6565 Finisher V1	Staples per Cartridge - Type X1 box of 3	set	50
5	Canon imageRUNNER C5250i	Toner Canon C-EXV 28 SET (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	25
6	Canon imageRUNNER C5250i	Drum Unit grup Canon C-EXV 28 SET (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	12
7	Canon i-SENSYS LBP-5050	Toner Canon 716 Set (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	4
8	HP Laserjet 1010	Toner HP 12A	Cope	9

9	HP laserjet color mfp 178në	Toner hp 117a (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	2
10	Hp laserjet P1102	Toner 85A Black CE285AC	Cope	20
11	Hp LaserJet Pro 400M401dn	Toner HP 80A	Cope	10
12	Kyocera Ecosys FS-1300D	Kyocera TK-130 Drum Unit grup	Cope	9
13	Kyocera Ecosys FS-1300D	Kyocera TK-130 Toner Cartridge	Cope	25
14	Kyocera Ecosys FS-1370dn	Kyocera TK-170 Black Drum Unit	Cope	5
15	Kyocera Ecosys FS-1370dn	Kyocera TK-170 Toner Cartridge	Cope	25
16	Kyocera Ecosys FS-6525MFP	Kyocera TK-475	Cope	70
17	Lexmark B2338	Lexmark B2338dë Drum Unit	Cope	10
18	Lexmark B2338	Lexmark toner B232000	cope	50
19	Lekxmark E 120	Toner Lexmark 12015SA	Cope	3
20	Lekxmark E 120	Lexmark Imaging Unit (drum unit)	cope	5
21	Samsung ML- 1640	MLT-D1082S	Cope	2
22	Kyocera TASKalfa 2200	Kyocera TK-4105 Toner Cartridge	Cope	20
23	Samsung SCX 3400	Samsung MLT-D101S	Cope	10
24	RICOH-Aficio MP201	Toner Ricoh Aficio 1270D	cope	6
25	Canon MG2550S Color	Toner Canon PG-545XL/CL-546XL High	Set	6
26	KYOCERA 3920DN	Drum Unit Kyocera DK-320	cope	24
27	KYOCERA 3920DN	Toner Kyocera TK-350	cope	40
28	Canon LBP 3460	Toner Canon 710h	cope	50
29	Canon IRA 400	Drum unit grup Cexv-37	Cope	25
30	Canon Ira400	Toner Canon Cexv-43	cope	100
31	Canon Lbp6780	Toner Canon 724H	cope	120

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.3. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.4. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin e kriterëve specifike, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, që përcaktojnë kriteret e kualifikimit duhet të jenë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se qëllimi i vendosur nga ligjvënësi, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike (referuar nenit 21 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor, të mostrave të dorëzuara, në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi ka kufizuar të drejtën e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit në respekt të parimit të proporcionalitetit, si një parim gjithëpërfshirës në ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit me rëndësinë që ka për vlerësimin e ofertës teknike. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të LPP-së. Komisioni konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e synimit, autoriteti kontraktor ka

parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, si edhe kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa nga artikujt objekt-prokurimi. Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për më tepër, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar paraqitjen e mostrave për shumicën e artikujve që do të prokurohen, por vetëm për një pjesë të tyre, duke kërkuar arikujt që kanë përdorueshmëri më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me mostat në përputhje me ligjin e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK se; *[...]Afat i levrimit per kete procedure eshte 30 dite. Artikujt objekt prokurimi jane shume te vecante dhe shpesh ndodh qe edhe furnitoret nuk mbajne gjendje keto produkte, por kerkojne kohen e tyre per ti siguruar. Ne situaten e tanishme, jemi te gjithë te vetedijshem per veshtiresite e medha ne fushen e sigurimit te produkteve dhe realizimit te transporteve. Ne keto kushte, afati prej 30 dite eshte teresisht i pamjaftueshem. Kerkojme qe ky afat te behet 60 dite[...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojca 6 “Formulari i Sasise dhe grafikut te levrimit” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas tabelës së mëposhtme.

Afatet e levrimit: 30 ditë

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i Printerit</i>	<i>Modeli</i>	<i>njesia</i>	<i>sasia</i>	<i>Destinacioni</i>	<i>Periudha e dorezimit</i>
1	Canon IR-Advance 6565	Toner C-EXV36	Cope	38	Bashkia Kamez	30 dite
2	Canon IR-Advance 6055	Drum Canon IR-Advance 6055	cope	5		
3	Canon IR-Advance 6055	Canon imageRUNNER ADVANCE 6055 Fuser (Komplet)	Cope	4		
4	Canon IR-Advance 6565 Finisher V1	Staples per Cartridge - Type X1 box of 3	set	50		
5	Canon imageRUNNER C5250i	Toner Canon C-EXV 28 SET (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	25		
6	Canon imageRUNNER C5250i	Drum Unit grup Canon C-EXV 28 SET (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	12		
7	Canon i-SENSYS LBP-5050	Toner Canon 716 Set (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	4		
8	HP Laserjet 1010	Toner HP 12A	Cope	9		
9	HP laserjet color mfp 178në	Toner hp 117a (Black, Cyan, Magenta, Yelloë)	Set	2		
10	Hp laserjet P1102	Toner 85A Black CE285AC	Cope	20		
11	Hp LaserJet Pro 400M401dn	Toner HP 80A	Cope	10		
12	Kyocera Ecosys FS-1300D	Kyocera TK-130 Drum Unit grup	Cope	9		
13	Kyocera Ecosys FS-1300D	Kyocera TK-130 Toner Cartridge	Cope	25		
14	Kyocera Ecosys FS-1370dn	Kyocera TK-170 Black Drum Unit	Cope	5		
15	Kyocera Ecosys FS-1370dn	Kyocera TK-170 Toner Cartridge	Cope	25		
16	Kyocera Ecosys FS-6525MFP	Kyocera TK-475	Cope	70		

17	Lexmark B2338	Lexmark B2338dë Drum Unit	Cope	10
18	Lexmark B2338	Lexmark toner B232000	cope	50
19	Lekxmark E 120	Toner Lexmark 12015SA	Cope	3
20	Lekxmark E 120	Lexmark Imaging Unit (drum unit)	cope	5
21	Samsung MI- 1640	MLT-D1082S	Cope	2
22	Kyocera TASKalfa 2200	Kyocera TK-4105 Toner Cartridge	Cope	20
23	Samsung SCX 3400	Samsung MLT-D101S	Cope	10
24	RICOH-Aficio MP201	Toner Ricoh Aficio 1270D	cope	6
25	Canon MG2550S Color	Toner Canon PG-545XL/CL-546XL High	Set	6
26	KYOCERA 3920DN	Drum Unit Kyocera DK-320	cope	24
27	KYOCERA 3920DN	Toner Kyocera TK-350	cope	40
28	Canon LBP 3460	Toner Canon 710h	cope	50
29	Canon IRA 400	Drum unit grup Cexv-37	Cope	25
30	Canon Ira400	Toner Canon Cexv-43	cope	100
31	Canon Lbp6780	Toner Canon 724H	cope	120

III.3.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III 3.3 Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III3.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.3.5 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret nga ana e ankimuesit kërkohet rritja e afatit të lëvrimit pasi përcaktimi në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankim “Afatet e lëvrimit: 30 ditë”, është jo i mjaftueshëm për lëvrimin e mallit.

III.3.5 Sa më sipër, KPP referuar pretendimit të ankimuesit, gjykon, se periudha e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi është e mjaftueshme për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e mallit që do të lëvrohet, volumit të kontratës dhe shpërndarjes së tyre. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret është në përputhje me përmasat e kontratës dhe

ofertuesit kanë kohë të mjaftueshme për sigurimin në kohë të mallit me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit “Infosot Office” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-32771-06-14-2022 me objekt “Blerje bojëra për printer e fotokopje”, me fond limit 5,800,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27-06-2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

